VENDIM
Nr. 2, datë 21.1.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 21.1.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 12 (D) 2024, që u përket:

KËRKUESE: DASHMIRA ZARO

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

ARBEN ÇABEJ,

SHEFIKO ÇABEJ, LULJANA ÇABEJ, ESMERALDA ÇABEJ, JUNIK ÇABEJ, EDUART ÇABEJ, ROZETA ÇABEJ, ILIR ILIADHI, MIRELA ILIADHI, NEBIJE ÇABEJ, LORENC ÇABEJ, DORJANA ÇABEJ, SANIE CIKO, VASIL NDINO, ELISABETA ÇABEJ, ANILA ÇABEJ, ALTIN ÇABEJ, ALFRED LILAJ, HYRIJE LILAJ, NATASHA SHKURTI (LILAJ), në mungesë,

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm, Ëngjëll Agaçi,

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, përfaqësuar nga Etleva Malile, me autorizim,

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm, Llambriola Misto,

AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga avokatet e shtetit Irma Qosja dhe Valbona Legisi,

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, në mungesë,

BASHKIA GJIROKASTËR, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm, Nertil Nebiaj,

SHOQËRIA "A.L. ASFALT" sh.p.k., në mungesë,

SHOQËRIA "ERAL CONSTRUCTION COMPANY" sh.p.k., në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2666, datë 26.2.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes.

Urdhërimi i Gjykatës Administrative të Apelit për gjykimin brenda 3 muajve të çështjes nr. 31154-02296-86-2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, 141 dhe pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkueses, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Arben Çabej, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë *(MIE)*, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit *(MEKI)*,

Avokaturës së Shtetit, Bashkisë Gjirokastër, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim nga subjektet e tjera të interesuara, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Bashkia Gjirokastër ka nxjerrë lejen zhvillimore nr. 6, datë 16.7.2014 për projektin në Parkun e Viroit, sistemimin e tij, rikonstruktimin e rrugës së parkut dhe ndriçimin e trotuarit nga ana e qytetit. Kontrata për zbatimin e projektit është lidhur me operatorët ekonomikë "A.L. Asfalt" sh.p.k. dhe "Eral Construksion Company" sh.p.k., bazuar në procedurat e prokurimit publik.

2. Me pretendimin se zhvillimi i projektit prekte pasurinë e tyre, në datën 8.9.2014 kërkuesja dhe subjekti i interesuar Arben Çabej i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me kërkesë për sigurimin e padisë dhe pezullimin e punimeve të nisura, ndërsa në datën 3.11.2014 kanë ngritur padi në gjykatë kundër Bashkisë Gjirokastër e të tjerë, me objekt kallëzimin e një punimi të ri dhe dëmi të mundshëm, detyrimin e tyre të kthejnë sendin ose të paguajnë vlerën e plotë të pronës, si dhe sigurimin e padisë përmes pezullimit të punimeve.

3. Gjatë kohës që çështja po shqyrtohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me kërkesë të Bashkisë Gjirokastër dhe propozim të ministrisë së linjës, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 322, datë 15.4.2015 "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projekteve në Parkun e Viroit: Sistemim i Parkut të Viroit, rikonstruksion i rrugës në Parkun e Viroit nga ana e qytetit, ndriçimi i trotuarit në Parkun e Viroit nga ana e qytetit" *(VKM nr. 322/2015)*. Një prej pronarëve të shpronësuar, që prekeshin nga realizimi i projektit, ishte edhe kërkuesja.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, në datën 11.9.2014 ka rrëzuar kërkesën për sigurimin e padisë, ndërsa në datën 8.6.2015 ka shpallur moskompetencën lëndore për shqyrtimin e padisë, duke ia dërguar aktet e çështjes për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër. Ndonëse kërkuesja dhe Arben Çabej kanë paraqitur rekurs të veçantë, vendimi për kompetencën është lënë në fuqi me vendimin e datës 3.12.2015 të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, çështja gjyqësore është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër në datën 8.2.2016. Në përfundim të gjykimit, kjo e fundit, me vendimin nr. 383, datë 9.6.2016, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke detyruar Ministrinë e Zhvillimit Urban të shpërblejë paditësit dhe bashkëpronarët e tjerë për efekt shpronësimi në shumën 119.717.920 lekë, sipas pjesëve takuese, si dhe rrëzimin e kërkimeve të tjera të padisë. Kundër këtij vendimi kërkuesja dhe të tjerë kanë paraqitur apel.

5. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 7.9.2016. Pas disa ditësh, në datën 21.9.2016, kërkuesja i është drejtuar kryetarit të asaj gjykate me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit, të cilën e ka përsëritur në datën 22.2.2017. Bazuar në nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*, që hynë në fuqi në datën 5.11.2017, kërkesa i është përcjellë Gjykatës së Lartë dhe është regjistruar në këtë të fundit në datën 5.3.2018. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka konstatuar se ndërkohë gjykata e apelit e kishte vënë në lëvizje çështjen e kërkueses, duke caktuar seancën gjyqësore. Mbi bazën e këtij konstatimi, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 5, datë 17.4.2018, ka vendosur pushimin e shqyrtimit të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, me arsyetimin se gjykata e apelit kishte ndërmarrë hapat për gjykimin sa më të shpejtë të çështjes.

6. Në vijim, Gjykata Administrative e Apelit ka përfunduar shqyrtimin e çështjes së kërkueses dhe, me vendimin nr. 2276, datë 4.6.2018, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Pas rigjykimit të çështjes, ku bashkëpronarët e tjerë të pronës kanë marrë pjesë si ndërhyrës kryesorë, duke kërkuar edhe ata detyrimin e të paditurve të

paguajnë vlerën e plotë të saj, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, me vendimin nr. 326, datë 14.6.2019, ka vendosur rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi kërkuesja dhe të tjerë kanë paraqitur apel.

7. Me vendimin nr. 39, datë 15.2.2022, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër të datës 14.6.2019 dhe pushimin e çështjes, me arsyetimin se prona, objekt gjykimi, tashmë i ishte nënshtruar procedurës së shpronësimit, procedurë që nuk ishte kundërshtuar nga paditësit.

8. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs të veçantë në Gjykatën e Lartë, i cili është regjistruar me nr. 31003-00134-2022, datë 10.5.2022. Në datën 14.6.2022 ajo i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së shqyrtimit të rekursit të veçantë. Në datën 8.9.2022 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se kohëzgjatja prej 5 muajsh e shqyrtimit të rekursit nuk e kishte kaluar afatin ligjor 2-vjeçar të parashikuar si afat të arsyeshëm orientues për shqyrtimin e çështjeve administrative në Gjykatën e Lartë.

9. Në datën 6.9.2022 (dy ditë përpara se Gjykata e Lartë të vendoste rrëzimin e kërkesës për përshpejtim), kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë, përshpejtimin e procedurës së shqyrtimit të rekursit të veçantë dhe konstatimin e mungesës së mjetit efektiv për mbrojtjen e së drejtës së saj. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 148, datë 9.11.2022, ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare, me arsyetimin se pretendimet ishin haptazi të pabazuara në kushtet kur nuk konstatohej vonesë në shqyrtimin e rekursit të kërkueses.

10. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar rekursin e veçantë të kërkueses dhe ka konstatuar se kërkimi për vlerën e pronës ishte ngritur përpara se të hynte në fuqi VKM-ja nr. 322/2015 për shpronësimin, ndaj gjykata e apelit kishte gabuar kur kishte vendosur pushimin e gjykimit për këtë kërkim, ndërsa lidhur me kërkimet për rivendikimin e pronës dhe kallëzimin e një punimi të ri, vlerësimi i gjykatës së apelit ishte i drejtë. Me këtë arsyetim, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2656 (113), datë 23.3.2023, ka vendosur: (i) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në shkallë të dytë për sa i përket kërkimit për vlerën e pronës, (ii) lënien në fuqi të vendimit për kërkimet e tjera.

11. Pas këtij vendimi të Gjykatës së Lartë, çështja e kërkueses është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 7.9.2023, me nr. 31154-02296-86-2023. Në datën 9.1.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të shqyrtimit të çështjes, të dërguar për herë të tretë për gjykim në gjykatën e apelit. Në kërkesën e nënshkruar personalisht prej saj, kërkuesja ka parashtruar se, pas kthimit për rigjykim, ajo i ishte drejtuar me kërkesë për përshpejtimin e gjykimit si relatorit fillestar, ashtu edhe relatores së caktuar më pas. Po sipas kërkueses, ndonëse bazuar në nenin 460, pikat 3 dhe 4, të KPC-së dhe kreun II, pika 3.2, shkronja "a", të vendimit nr. 78, datë 30.5.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit" *(vendim nr. 78/2019 i KLGJ-së)*, çështja duhej shqyrtuar me përparësi, gjykimi vazhdonte prej 9 vjetësh.

12. Në datën 26.2.2024 gjyqtari i vetëm i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka vendosur kthimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, për shkak se nuk ishte nënshkruar nga një avokat. Sipas Gjykatës së Lartë, pavarësisht se kërkueses i ishte kërkuar ta nënshkruante kërkesën nga një avokat dhe të paraqiste aktin e përfaqësimit, sipas parashikimeve të neneve 474 dhe 399/5 të KPC-së, ajo nuk i kishte plotësuar këto të meta.

13. Në datën 12.7.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 26.9.2024, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

14. Me vendimin nr. 30, datë 17.1.2024, "*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit*", Këshilli i Ministrave i ka kaluar kësaj ministrie kompetencat

e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ndaj në gjykimin e çështjes së kërkueses është bërë zëvendësimi procedural dhe palë ndërgjyqëse është MEKI.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. ***Kërkuesja*****,** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

15.1 E drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

15.1.1 E drejta e aksesit, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur kthimin e kërkesës, si rrjedhojë e mosnënshkrimit të saj nga avokati i autorizuar me prokurë, pa pasur detyrim ligjor dhe në kundërshtim me jurisprudencën kushtetuese.

15.1.2 E drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe *parimi i sigurisë juridike*, pasi gjykimi i çështjes vijon prej më shumë se 9 vjetësh e 6 muajsh. Shqyrtimi i saj për herë të tretë në gjykatën e apelit nuk ka përfunduar ende, në kundërshtim me nenin 399/2, pika 1, shkronja "a", të KPC-së. Seanca e parë në gjykatën e apelit është zhvilluar në dhomën e këshillimit në datën 3.11.2024, seancat gjyqësore janë caktuar në intervale kohore të njëjta me çështjet që gjykohen për herë të parë ose të dytë. Gjykimi zvarritet nga njoftimi me shpallje i subjekteve. Gjykimi në apel është pezulluar në kundërshtim me nenin 297 të KPC-së dhe në shkelje të *parimit të disponibilitetit,* pasi bashkëpronarët janë thirrur në gjykim kryesisht nga gjykata e shkallës së parë, pa qenë pjesë e ndërgjyqësisë së detyrueshme. Vendimi i pezullimit nuk plotëson *standardin kushtetues të arsyetimit*.

15.2 E drejta për një mjet ligjor efektiv, pasi Gjykata e Lartë duke kthyer kërkesën, nuk i ka dhënë përgjigje kërkimit për të urdhëruar gjykatën e apelit të përfundojë gjykimin brenda 3 muajve.

16. ***Subjekti i interesuar, Arben Çabej****,* në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar:

16.1 Gjykata e Lartë ka cenuar *të drejtën e aksesit*, si dhe *të drejtën për një mjet ligjor efektiv*, pasi neni 399/5 i KPC-së nuk kërkon nënshkrimin nga mbrojtësi të kërkesës për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit.

16.2 Kërkueses i është cenuar edhe *e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi nga regjistrimi për herë të tretë i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit ka kaluar mbi një vit dhe për çështjen nuk ka ende një vendim. Intervalet kohore të caktimit të seancave nga kjo gjykatë nuk kanë asnjë ndryshim nga çështjet e tjera që gjykohen për herë të parë ose të dytë.

16.3 Gjykata e apelit kur vendosi pushimin e gjykimit të çështjes ka cenuar parimet e *gjykimit të çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj* dhe *sigurisë juridike*, pasi nuk ka respektuar konkluzionet e vendimit të mëparshëm të saj të datës 4.6.2018, si dhe të vendimit të Gjykatës së Lartë që i kishte përcaktuar kompetencën.

17. ***Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar se:

17.1 Pretendimi për *cenimin e së drejtës së aksesit* është i pabazuar, pasi neni 399/5, pika 2, i KPC-së kërkon depozitimin e prokurës kur kërkesa për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e gjykimit bëhet nga avokati. Kërkuesja duhet të kishte plotësuar të metën e kërkesës, duke e nënshkruar atë nga mbrojtësi. Për këtë shkak, ajo *nuk ka shteruar mjetet juridike efektive*.

17.2 Pretendimi për cenimin e *së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm* është i pabazuar. *Sjellja e palëve në proces* dhe *e autoriteteve* nuk ka ndikuar në kohëzgjatjen e procesit. Gjykata e apelit ka vepruar brenda afateve ligjore për të siguruar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Ajo ka zhvilluar seanca çdo muaj, duke caktuar edhe dy në muaj. Gjykimi është pezulluar në zbatim të nenit 297, shkronja "c", të KPC-së, sepse një nga palët ka ndërruar jetë. Edhe pas paraqitjes së ankimit kushtetues individual, gjykata e apelit ka zhvilluar seancë në datën 15.10.2024, në të cilën ka verifikuar se shkaku i pezullimit nuk ka rënë.

18. ***Subjektet e interesuara, MKEI-ja, MIE-ja*** **dhe** ***Bashkia Gjirokastër*****,** kanë prapësuar se janë të pabazuara pretendimet për cenimin e së *drejtave të aksesit dhe për gjykim brenda afatit të arsyeshëm*, me të njëjtat argumente të paraqitura nga Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit. Në shtesë

të atyre argumenteve, ato kanë evidentuar se gjykimi në shkallë të dytë ka zgjatur edhe për shkak të ngarkesës së punës në atë gjykatë.

19. ***Subjektet e tjera të interesuara*** nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, megjithëse janë njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

20. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

21. Kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

22. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete *(shih vendimet nr. 6, datë 15.2.2024; nr. 64, datë 30.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*. Lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata, pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni në fuqi parashikon mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individi duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues *(shih vendimet nr. 68, datë 7.12.2023; nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

23. Gjykata vëren se kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual, pasi i është drejtuar më parë me kërkesë Gjykatës së Lartë, në zbatim të nenit 399/6, pika 1, shkronja "b", të KPC-së, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së saj nga Gjykata Administrative të Apelit, kërkesë e cila ishte nënshkruar personalisht prej saj. Me vendimin nr. 00-2024-2666, datë 26.2.2024, gjyqtari i vetëm i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka vendosur kthimin e kërkesës, si rrjedhojë e mungesës së nënshkrimit të mbrojtësit dhe të aktit të përfaqësimit, duke iu referuar përmbajtjes së nenit 399/5, pika 2, shkronja "ç", të KPC-së.

24. Në kontekstin e këtyre rrethanave, kërkuesja ka pretenduar se e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike, por Gjykata e Lartë duke ia kthyer kërkesën, për shkak të formalizmave të tepruar, i ka cenuar asaj të drejtën e aksesit në gjykatë dhe atë të zgjidhjes efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 13 i KEDNJ-së. Ndërsa subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se kërkuesja nuk i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, për sa kohë kërkesën për konstatimin e shkeljes, që ia ka drejtuar Gjykatës së Lartë, nuk e ka shoqëruar me prokurën e avokatit, ndaj kthimi i kërkesës ishte në përputhje me ligjin procedural.

25. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se kthimi pa veprim i kërkesave drejtuar Gjykatës së Larë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit

bazuar në dispozitat që përcaktojnë nënshkrimin nga avokati të rekursit, përbën formalizëm të tepruar dhe kthen një rregull garantues procedural në një pengesë të aksesit në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit ka detyrimin të sillet në atë mënyrë që kërkesa për përshpejtim të mos humbasë qëllimin e vet dhe individit të mos i cenohet në thelb e drejta për mjet juridik efektiv *(shih vendimet nr. 80, datë 21.11.2024; nr. 58, datë 17.9.2024; nr. 37, datë 5.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

26. Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata vëren se kërkuesja ka shfrytëzuar mjetin juridik në dispozicion të saj, duke e paraqitur kërkesën në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit nuk e ka shqyrtuar themelin e kërkesës, por ia ka kthyer kërkueses me arsyetimin se duhej nënshkruar nga një avokat dhe se duhej paraqitur akti i përfaqësimit, ndonëse kërkesa ishte nënshkruar personalisht nga vetë kërkuesja. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka mbajtur qasje formaliste dhe e ka shndërruar kërkesën në mjet ankimi joefektiv. Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkuesja e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike në dispozicion, ndaj prapësimi i subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Avokaturës së Shtetit, në këtë drejtim është i pabazuar.

27. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit kushtetues, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës në datën 12.7.2024, ndërsa vendimi gjyqësor që ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes, i cili mban datën 26.2.2024, i është njoftuar kërkueses me postë elektronike në datën 12.7.2024. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, sepse jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

28. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, që garantohet nga neni 42 i Kushtetutës, pretendim që përfshihet në kompetencën e Gjykatës. Në këtë pikë duhet evidentuar se kërkuesja e ka përmbushur detyrimin për shterimin e mjeteve juridike, duke iu drejtuar paraprakisht me kërkesë Gjykatës së Lartë, por kjo e fundit e ka kthyer atë pa veprime (*shih paragrafin 26 të vendimit*), duke mos i dhënë përgjigje pretendimit për cenimin e së drejtës kushtetuese të kërkueses, pra duke mos përmbushur rolin e saj subsidiar për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave themelore. Duke mbajtur në konsideratë që thelbi i së drejtës kushtetuese për gjykim brenda afatit të arsyeshëm lidhet me kohëzgjatjen e procedurave, shkak për të cilin ligji procedural ka caktuar afatin e shpejtë 45-ditor për shqyrtimin e kërkesave të tilla nga gjykatat e zakonshme, Gjykata arrin në përfundimin se kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë nuk i përgjigjet mbrojtjes së të drejtës themelore në fjalë, ndaj çmon se duhet ta analizojë ajo vetë themelin e pretendimit për cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

29. Kërkuesja ka pretenduar se çështja e saj po gjykohet përtej afatit të arsyeshëm, gjykimi vazhdon prej më shumë se 9 vjetësh dhe aktualisht çështja po shqyrtohet për herë të tretë nga Gjykata Administrative e Apelit në intervale të njëjta kohore me çështje të tjera që po shqyrtohen për herë të parë ose të dytë pranë asaj gjykate. Sipas saj, gjykimi është pezulluar për të thirrur në gjykim trashëgimtarët e palëve ndërgjyqëse që kanë ndërruar jetë, pjesëmarrja e të cilëve nuk është detyrim ligjor. Subjekti i interesuar, Arben Çabej, i është bashkuar qëndrimit të kërkueses, duke parashtruar se çështja është kthyer për shqyrtim për herë të tretë në gjykatën e apelit dhe seancat gjyqësore janë caktuar në intervale të gjata kohore.

30. Subjektet e tjera të interesuara, Këshilli i Ministrave MIE-ja, MEKI-ja, Avokatura e Shtetit dhe Bashkia Gjirokastër, kanë prapësuar se pretendimi i kërkueses është i pabazuar, pasi Gjykata Administrative e Apelit ka vepruar brenda afateve ligjore, duke zhvilluar seanca çdo muaj, madje edhe dy herë në muaj. Sipas tyre, gjykimi është pezulluar në përputhje me ligjin dhe lidhet me rregullimin e ndërgjyqësisë. Po sipas tyre, kohëzgjatja e gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit është rrjedhojë edhe e ngarkesës së punës.

31. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të

procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi *(shih vendimet nr. 27, datë 11.4.2024; nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

32. Gjykata vëren se çështja e kërkueses është e natyrës administrative dhe ka të bëjë me kundërshtimin e veprimeve të kryera në pronën e kërkueses, si rrjedhojë e zbatimit të një projekti të Bashkisë Gjirokastër, si dhe rivendikimin e pronës ose shpërblimin e saj. Procesi gjyqësor është vënë në lëvizje përmes padisë së paraqitur nga kërkuesja, që është regjistruar në gjykatën e shkallës së parë në datën 3.11.2014 dhe deri më sot nuk ka ende një zgjidhje përfundimtare nga gjykatat e zakonshme për të gjitha kërkimet e padisë, të cilat kanë ndryshuar gjatë gjykimit. Kështu, kërkimet fillestare të kërkueses për kallëzimin e një punimi të ri dhe për padinë e rivendikimit kanë përfunduar së shqyrtuari me vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 23.3.2023. Ndërsa kërkimi për vlerën e pronës, i parashtruar nga kërkuesja në formën e shtesës së objektit të padisë në datën 26.12.2014 dhe nga ndërhyrësit kryesorë (bashkëpronarët e tjerë të pronës) në rigjykimin e çështjes në shkallë të parë, për të cilin Gjykata e Lartë ka kthyer çështjen për rishqyrtim në apel, vijon të jetë në shqyrtim në gjykatat e zakonshme prej rreth 10 vjetësh. Çështja është regjistruar për herë të tretë në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 7.9.2023 dhe ndonëse ka kaluar rreth 1 vit e 4 muaj, gjykimi në shkallë të dytë për këtë kërkim nuk ka përfunduar.

33. Për sa u takon këtyre fakteve, Gjykata vëren se KPC-ja, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të parë e në apel nga fillimi i tij në secilën shkallë (neni 399/2, pika 1, shkronja "a", i KPC-së) dhe afatin 2-vjeçar për kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit të çështjeve civile nga Gjykata e Lartë (neni 399/2, pika 1, shkronja "b", i KPC-së), i cili gjen zbatim edhe në shqyrtimin e çështjeve administrative.

34. Duke analizuar rrethanat e mësipërme, Gjykata konstaton se gjykimi i çështjes së kërkueses në tërësi ka tejkaluar afatet ligjore, por ajo nuk ka paraqitur kundërshtime për ecurinë e çështjes në shkallët e ndryshme të gjykimit, duke i orientuar ato vetëm për vonesën në gjykimin e fundit në Gjykatën Administrative të Apelit, ku çështja e saj po shqyrtohet për herë të tretë. Në këto rrethana, për të vlerësuar nëse tejzgjatja e afatit është e paarsyeshme, pra nëse kërkueses i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkueses; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesja *(shih vendimet nr. 65, datë 2.10.2024; nr. 68, datë 7.12.2023; nr. 13, datë 26.5.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

i) Sjellja e kërkueses

35. Gjykata vëren se ndonëse kërkesëpadia kishte të bënte me kundërshtimin e veprimeve të organit administrativ, Bashkisë Gjirokastër, ajo e ka paraqitur atë në datën 11.9.2014 në gjykatën e rrethit gjyqësor, e cila ka shpallur moskompetencën lëndore dhe ia ka dërguar aktet gjykatës administrative të shkallës së parë. Kërkuesja ka rekursuar vendimin për shpalljen e moskompetencës në Gjykatën e Lartë dhe kjo e fundit e ka vlerësuar të drejtë atë. Në vijim, çështja është regjistruar në gjykatën administrative. E gjithë procedura, nga momenti i depozitimit të kërkesëpadisë në gjykatën e rrethit deri në regjistrimin e çështjes në Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, pas zgjidhjes së kompetencës nga Gjykata e Lartë, ka zgjatur rreth 1 vit e 3 muaj. Për sa u takon veprimeve të tjera të kërkueses, rezulton se përgjatë procesit gjyqësor ajo ka vepruar në përputhje me të drejtat e saj procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes.

36. Për sa më lart, Gjykata çmon se sjellja e kërkueses, përmes depozitimit të kërkesëpadisë në gjykatën jokompetente dhe rekursimit të vendimit gjyqësor që i dërgonte çështjen për shqyrtim gjykatës kompetente, ka sjellë një vonesë në kohëzgjatjen tërësore të gjykimit të çështjes së saj, por nuk ka qenë shkak për vonesën në gjykimin që po zhvillohet aktualisht në gjykatën e apelit.

ii) Kompleksiteti i çështjes

37. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e këtij kriteri marrin rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin, faktet e kundërshtuara, volumin dhe natyrën e

provave, llojin dhe ndërthurjen e ligjeve të zbatueshme, si dhe numrin e palëve pjesëmarrëse në proces. Kohëzgjatja e konsiderueshme e gjykimit mund të justifikohet nga kompleksiteti i çështjes, pasi balancohet nga parimi i administrimit të përshtatshëm të drejtësisë *(shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022 të Gjykatës Kushtetuese).*

38. Në rastin konkret, nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata konstaton se çështja e kërkueses është gjykuar dy herë në shkallë të parë, tre herë në shkallë të dytë dhe një herë në Gjykatën e Lartë. Objekti i padisë së saj ka pasur më tepër se një kërkim, si dhe është ndryshuar prej saj gjatë gjykimit, duke u kërkuar pagesa e vlerës së plotë të pronës me të marrë njoftimin e Bashkisë Gjirokastër se prona do të shpronësohej për interes publik. Po kështu, numri i palëve ndërgjyqëse është rritur vijimësisht dhe aktualisht aty marrin pjesë 2 paditës, 12 ndërhyrës kryesorë, 4 të paditur, 1 ndërhyrës dytësor në mbështetje të paditësve dhe 11 persona të tretë, nga të cilat 3 janë institucione shtetërore. Edhe provat e shqyrtuara kanë qenë të shumta, përfshirë aktet e ekspertimit dhe pyetjet me shkrim të ekspertit. Po ashtu, legjislacioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes nuk ka qenë i thjeshtë, pasi përfshinte jo vetëm atë për të drejtat e pronësisë, por edhe ligjet për kompetencat e pushtetit vendor dhe atij qendror. Për tepër, legjislacioni ka pësuar edhe ndryshime gjatë gjykimit, siç ishte hyrja në fuqi e VKM-së nr. 322/2015. Një rrethanë tjetër lidhej edhe me pandeminë COVID-19, që ka ndikuar në ecurinë e çështjes.

39. Më konkretisht, *gjykimi i parë* i çështjes nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, i zhvilluar pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 322/2015, ka zgjatur 4 muaj, ndërsa gjykimi i ankimeve të paraqitura prej saj dhe personave të tjerë në Gjykatën Administrative të Apelit rreth 1 vit e 8 muaj. Gjatë gjykimit në shkallë të dytë palët kanë paraqitur kërkesa të ndryshme procedurale. Kërkuesja ka kërkuar kalimin procedural të palëve në proces, ndërsa subjektet e tjera kanë kërkuar thirrjen në gjykim të personave të tretë, si dhe të ndërhyjnë si palë në gjykim. Në përfundim, gjykata e apelit ka vendosur kthimin e çështjes për rishqyrtim në shkallë të parë, duke vlerësuar se gjykata e asaj shkalle duhej të orientonte palën paditëse (përfshirë kërkuesen) në lidhje me ndërgjygjësinë ose të thërriste si persona të tretë në gjykim bashkëpronarët e tjerë dhe Këshillin e Ministrave, nëse objekt i shqyrtimit gjyqësor do të ishte edhe VKM-ja nr. 322/2015.

40. *Gjykimi për herë të dytë* (rigjykim) nga gjykata e shkallës së parë ka zgjatur rreth 1 vit, nga gjykata e apelit rreth 2 vjet e 8 muaj, ndërsa nga Gjykata e Lartë rreth 10 muaj. Në gjykimin në shkallë të parë palët kanë parashtruar kërkesa të ndryshme për shtimin e objektit të padisë, thirrjen në gjykim të personave të tretë, ndërhyrjen si persona të tretë ose si trashëgimtarë, pushimin e gjykimit në lidhje me pozitën e ndërhyrësit dytësor, si dhe pezullimin e gjykimit deri në zgjidhjen e një tjetër çështjeje nga Gjykata e Lartë. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar të nevojshme kryerjen e ekspertimit vlerësues të pasurive të paluajtshme dhe topografisë. Në lidhje me gjetjet e aktit të ekspertimit, kërkuesja ka bërë pyetje dhe kërkesa shtesë, të cilave eksperti u ka dhënë përgjigje përmes sqarimeve plotësuese. Në shkallë të dytë vonesa në shqyrtimin e çështjes lidhet edhe me situatën e përgjithshme të krijuar në vend nga pandemia COVID-19. Në përfundim, gjykata e apelit ka vendosur pushimin e gjykimit, vendim i cili është prishur nga Gjykata e Lartë, duke u kthyer çështja për rigjykim sërish në gjykatën e apelit për sa i përket kërkimit të kërkueses për pagimin e vlerës së plotë të pronës.

41. *Gjykimi për herë të tretë* në gjykatën e apelit ka filluar me regjistrimin e çështjes në datën 7.9.2023. Ajo është rishortuar tre herë për shkak të pranimit të kërkesave për dorëheqje të dy gjyqtarëve të parë të caktuar me short. Gjyqtarja e fundit ka kryer veprimet e nevojshme procedurale për njoftimin e palëve në proces, duke kërkuar informacion edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për adresat e disave prej tyre. Në kushtet kur në gjykim është konstatuar se disa nga palët kanë ndërruar jetë, gjykata ka proceduar me kalimin procedural të të drejtave të tyre tek trashëgimtarët. Po kështu, kalimi procedural është bërë nga gjykata edhe për palët në gjykim subjekte publike, të drejtat dhe përgjegjësitë e të cilave u kanë kaluar organeve të tjera shtetërore. Ndërsa në datën 11.7.2024 gjykata ka konstatuar se një person i tretë (një prej

bashkëpronarëve) ka ndërruar jetë dhe për këtë shkak ka vendosur pezullimin e gjykimit deri në thirrjen e trashëgimtarëve të tij.

42. Për sa i takon vendimit të pezullimit, Gjykata evidenton se nga materialet e çështjes nuk rezulton të ketë një vendim të një gjykate më të lartë që të jetë shprehur se thirrja në gjykim e palëve ndërgjygjëse nga gjykata e apelit është në kundërshtim me parimin e disponibilitetit të padisë. Për këtë arsye, duke mbajtur në konsideratë parimin e subsidiaritetit dhe faktin që çështja është ende në gjykim, vlerëson se argumenti i kërkueses se thirrja e palëve ndërgjyqëse është bërë shkak për vonesën në gjykimin e çështjes nuk qëndron. Po ashtu, në ndryshim nga sa kërkuesja pretendon, Gjykata çmon se vendimi i pezullimit, i cili është një vendim i ndërmjetëm, plotëson standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi në pjesën arsyetuese tregon shkakun ligjor të pezullimit në raport me rrethanat e çështjes, si dhe bazën ligjore të zbatuar.

43. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se nisur nga natyra dhe objekti i padisë, e cila deri në mars të vitit 2023 përmbante 3 kërkime, volumi i konsiderueshëm i legjislacionit dhe ndryshimet e tij, numri i lartë i palëve në proces, kërkesat procedurale të paraqitura prej tyre, kalimet procedurale të kryera nga gjykatat përgjatë procesit, thirrjet në gjykim të subjekteve që për shkak trashëgimie ose ndryshimi përgjegjësie kanë ndërhyrë në të drejtat e subjekteve të mëparshme në gjykim, si dhe njoftimet për gjykimin e palëve që kanë hyrë në të drejtat e subjekteve që kanë ndërruar jetë, çështja paraqitet komplekse në këndvështrimin kushtetues në atë masë që e bën faktor përcaktues të kohëzgjatjes tërësore të gjykimit të çështjes së kërkueses, si dhe të tejzgjatjes së gjykimit aktual në gjykatën e apelit.

iii) Sjellja e autoriteteve

44. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në përmbushje të këtyre detyrimeve, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme *(shih vendimet nr. 25, datë 11.5.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

45. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se përgjatë procesit gjyqësor gjykatat kanë vepruar në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi dhe nuk rezulton të jenë bërë pengesë në kohëzgjatjen e gjykimit të çështjes. Ato kanë marrë masa për garantimin e të drejtave substanciale dhe procedurale të palëve të përfshira në proces, duke vendosur pa vonesa për kërkesat e paraqitura prej tyre gjatë gjykimit, si dhe duke garantuar pjesëmarrjen e tyre përgjatë procesit.

46. Gjykata vëren, gjithashtu, se Gjykata Administrative e Apelit (ku tashmë është duke u gjykuar çështja e kërkueses) ka informuar me shkrim në datën 26.12.2024 se pranë saj ndodhen për shqyrtim 23.866 çështje, ndërsa ushtrojnë detyrën 13 gjyqtarë. Aktualisht aty po shqyrtohen çështjet e regjistruara në vitin 2018, si dhe çështjet me përshpejtim shqyrtimi për kërkesën e palëve, ndërsa numri i çështjeve në ngarkim të gjyqtares relatore në datën 7.9.2024 ka qenë 2742. Po sipas këtij informacioni, data e ardhshme e seancës gjyqësore për shqyrtimin e çështjes së kërkueses është caktuar data 30.1.2025.

47. Pavarësisht kësaj ngarkese të lartë pune dhe numrit të ulët të gjyqtarëve, të shkaktuar nga reforma në drejtësi, e cila gjithsesi nuk shkarkon autoritetet shtetërore nga detyrimi për të garantuar të drejtën kushtetuese të individëve për gjykim brenda afatit të arsyeshëm *(shih vendimet nr. 27, datë 11.4.2024; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 37, datë 5.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*, Gjykata vëren se pas kthimit për rigjykim nga Gjykata e Lartë, çështja e kërkueses është marrë në shqyrtim me përparësi nga gjykata e apelit, duke respektuar rregullat e vendimit nr. 78/2019 të KLGJ-së. Ajo ka zhvilluar 9 seanca gjyqësore, të caktuara në intervale kohore të arsyeshme në raport me shkakun e shtyrjes së tyre. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur pezullimin e gjykimit në datën 11.7.2024, për shkak të ndërrimit jetë të një pale në proces dhe thirrjes në gjykim të personave që kanë ndërhyrë në të drejtat e saj, duke vepruar sipas parashikimeve ligjore me qëllim administrimin e përshtatshëm të drejtësisë. Edhe pas pezullimit, ashtu siç kanë vënë në dukje subjektet e interesuara, gjykata e

apelit ka vepruar aktivisht, duke caktuar seancë për të verifikuar ekzistencën e shkakut të pezullimit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se sjellja e gjykatave nuk është bërë shkak për tejzgjatjen e çështjes së kërkueses.

iv) Rëndësia e asaj që rrezikon kërkuesja

48. Gjykata ka theksuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë", duhet të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë. Në këto raste duhet të merret parasysh rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi në procesin gjyqësor, pra rëndësia që ka për të e drejta objekt gjykimi. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe verifikimi i kriterit të interesit të kërkuesit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti *(shih vendimet nr. 65, datë 2.10.2024; nr. 67, datë 7.12.2023; nr. 35, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në rastin kur çështja gjyqësore ka në objektin e saj të drejtën e pronës private, Gjykata ka pohuar se përfshihet në listën e çështjeve me interes të rëndësishëm, pasi prona private përbën jo vetëm të drejtë themelore, por edhe një nga shtyllat kryesore ku mbështetet sistemi ekonomik dhe zhvillimi i vendit *(shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 1, datë 6.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese)*.

49. Në rastin konkret, Gjykata vëren se pjesa e padisë së kërkueses aktualisht për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit ka të bëjë me të drejtën substanciale të pronës. Kështu, në lidhje me kërkimet e saj të ngritura në kërkesëpadi për pagimin e vlerës së plotë të pronës, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se Bashkia Gjirokastër, duke mos respektuar ligjin për shpronësimin, ka ndërhyrë në mënyrë të paligjshme, duke zhveshur kërkuesen (dhe paditësin tjetër) nga posedimi i pronës në kundërshtim me ligjin. Për rrjedhojë, ajo është përgjegjëse për shkeljen e parimit të ligjshmërisë dhe dëmin e shkaktuar kërkueses, ndaj duhet të përgjigjet për zënien e pronës së paluajtshme në mënyrë të paligjshme dhe pasojat që vijnë prej saj *(shih faqen 13, paragrafi 24, të vendimit të Gjykatës së Lartë për çështjen e themelit)*.

50. Në këndvështrim të qëndrimit të Gjykatës së Lartë, që ka përcaktuar se në gjykimin administrativ kërkimi lidhet me të drejtën substanciale të pronës, Gjykata çmon se interesi i kërkueses për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm është i rëndësishëm.

51. Në përmbledhje të arsyetimit të mësipërm, Gjykata çmon se interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë për detyrimin e nënshkrimit nga mbrojtësi të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, si shkak për kthimin e kërkesës, nuk është në përputhje me Kushtetutën. Si rrjedhojë e atij interpretimi, vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën për akses në gjykatë dhe atë për zgjidhje efektive, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 13 i KEDNJ-së, ndaj duhet shfuqizuar. Po kështu, në vlerësim tërësor të rrethanave të analizuara sipas kritereve kushtetuese përcaktuese të kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e së drejtës për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm është i pabazuar, për shkak të kompleksitetit të çështjes, ndaj kërkimi për këtë të drejtë kushtetuese duhet rrëzuar.

52. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkueses duhet të pranohet pjesërisht (*shih paragrafin 25 të vendimit*), sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-2666, datë 26.2.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

3. Rrëzimin e kërkesës për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 21.1.2025.
Shpallur, më 19.2.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini
Anëtare pjesërisht kundër: Sonila Bejtja

MENDIM PJESËRISHT KUNDËR

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes, që i përket kërkueses Dashmira Zaro, me objekt: "*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2666, datë 26.2.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes. Urdhërimi i Gjykatës Administrative të Apelit për gjykimin brenda 3 muajve të çështjes me nr. 31154-02296-86-2023*", ndaj qëndrim të ndryshëm nga shumica për sa i takon vlerësimit të pretendimit të kërkueses për shkeljen e afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes, pasi çmoj se duhej të ishte vendosur pranimi i kërkesës edhe për këtë kërkim.

2. Në çështjen konkrete rezulton se në shtator të vitit 2014 kërkuesja dhe shtetasi Arben Çabej kanë vënë në lëvizje Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër për pezullimin e punimeve që kishin nisur të kryheshin në pasurinë e tyre, ndërsa në nëntor të këtij viti kanë paraqitur kërkesëpadi për kallëzimin e një punimi të ri dhe dëmi të mundshëm, detyrimin e Bashkisë Gjirokastër dhe operatorëve ekonomikë "A.L. Asfalt" sh.p.k. dhe "Eral Construksion Company" sh.p.k. (me të cilët është lidhur kontrata për zbatimin e projektit për sistemimin e Parkut të Viroit, rikonstruktimin e rrugës së parkut dhe ndriçimin e trotuarit nga ana e qytetit), të kthejnë pronën e tyre ose të paguajnë vlerën e plotë të saj, si dhe sigurimin e padisë përmes pezullimit të punimeve.

3. Pas vënies në lëvizje të procesit gjyqësor, në prill të vitit 2015, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM-në nr. 322 për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që prekeshin nga realizimi i projektit në Parkun e Viroit, ndërsa në qershor të vitit 2015 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka shpallur moskompetencën e saj lëndore për shqyrtimin e padisë, duke ia dërguar aktet për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër. Vendimi i gjykatës së rrethit për kompetencën është lënë në fuqi me vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër në datën 8.2.2016. Me vendim të dhënë 4 muaj më vonë, kjo e fundit ka pranuar pjesërisht kërkesëpadinë, duke detyruar Ministrinë e Zhvillimit Urban të shpërblejë kërkuesen dhe bashkëpronarët e tjerë për efekt shpronësimi, sipas pjesëve takuese, ndërsa pas kthimit të çështjes për rigjykim nga Gjykata Administrative e Apelit, në qershor të vitit 2019, gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë. Në shkurt të vitit 2022 gjykata e apelit ka vendosur pushimin e çështjes për të gjitha kërkimet, vendim i cili është prishur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në mars të vitit 2023, duke u kthyer çështja sërish për shqyrtim në apel, për sa i përket kërkimit për pagesën e vlerës së plotë të pronës objekt shpronësimi, ku dhe është regjistruar në datën 7.9.2023.

4. Përgjatë këtyre procedurave kërkuesja u është drejtuar gjykatave të zakonshme me kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit dhe përshpejtimin e procedurave. Në lidhje me to, me vendimin e prillit 2018, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur pushimin e shqyrtimit të kërkesës së saj të datës 21.9.2016, të përsëritur në datën 22.2.2017, duke vlerësuar se nga Gjykata Administrative e Apelit, ndaj së cilës ngriheshin pretendimet, ishin ndërmarrë hapat për gjykimin sa më të shpejtë të çështjes. Po kështu, me vendimin e nëntorit 2019,

Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin për shqyrtim në seancë plenare të kërkesës së kërkueses për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të shqyrtimit të rekursit të saj nga Gjykata e Lartë, duke vlerësuar se pretendimet ishin haptazi të pabazuara. Në datën 9.1.2024 kërkuesja i është drejtuar sërish Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të rigjykimit të çështjes tashmë nga Gjykata Administrative e Apelit, ku çështja ishte kthyer për shqyrtim. Në datën 26.2.2024 gjyqtari i vetëm i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka vendosur kthimin e kërkesës, me arsyetimin se pavarësisht se kërkuesja kishte marrë dijeni për detyrimin e nënshkrimin të saj nga mbrojtësi dhe shoqërimin me akt përfaqësimi, nuk i kishte plotësuar në kohë këto të meta. Ky vendim është kundërshtuar nga kërkuesja përmes ankimit kushtetues individual konkret, në të cilin është pretenduar, krahas shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes në tërësi e nga Gjykata Administrative e Apelit në veçanti, edhe cenimi i së drejtës së aksesit dhe së drejtës për mjet juridik efektiv nga Gjykata e Lartë.

5. Për sa u takon këtyre pretendimeve, me të drejtë, shumica ka çmuar si antikushtetues dhe në shkelje të së drejtës së aksesit e së drejtës për zgjidhje efektive interpretimin e ligjit nga Gjykata e Lartë për detyrimin e nënshkrimit nga mbrojtësi të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit. Ashtu si edhe shumica ka vlerësuar, qasja formaliste e mbajtur nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë ka çuar në mungesën e efektivitetit të mjeteve juridike të përcaktuara shprehimisht nga ligjvënësi në nenet 399/1 e vijues të KPC-së dhe në shkeljen e nenit 13 të KEDNJ-së *(shih paragrafët 25 dhe 51 të vendimit)*. Megjithatë, në ndryshim nga shumica, vlerësoj se në rastin e kërkueses duhej të ishte vendosur edhe konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pasi njohja vetëm e shkeljes së të drejtës së kërkueses për akses dhe për zgjidhje efektive pa konstatimin e cenimit të kësaj të drejte do të bënte që garantimi i së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së, të mbetej teorik dhe iluzor dhe jo praktik e efektiv, siç kërkon GJEDNJ-ja.

6. Po kështu, shumica, me të drejtë, ka vlerësuar të shqyrtojë pretendimet e kërkueses për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, duke konstatuar se çështja vijon të jetë në shqyrtim në gjykatat e zakonshme prej rreth 10 vjetësh dhe se, pas kthimit për rishqyrtim nga Gjykata e Lartë, ajo është në pritje të një vendimi në Gjykatën Administrative të Apelit prej më shumë se 1 viti e 4 muajsh, ndërkohë që neni 399/2, pika 1, shkronja "a", i KPC-së ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të dytë dhe afatin 2-vjeçar për kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit të çështjeve civile nga Gjykata e Lartë (neni 399/2, pika 1, shkronja "b", i KPC-së), i cili gjen zbatim edhe në shqyrtimin e çështjeve administrative. Në këto rrethana, për të përcaktuar nëse kërkueses i është cenuar e drejta kushtetuese, shumica ka marrë në analizë kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e saj; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesja *(shih paragrafët 34-50 të vendimit)*.

7. Shumica ka çmuar se: (i) kërkuesja është bërë pjesërisht shkak për tejzgjatjen e gjykimit si rrjedhojë e paraqitjes së kërkesëpadisë në gjykatën jokompetente dhe rekursimit të vendimit të gjykatës për dërgimin e çështjes gjykatës kompetente, ndërsa ka vlerësuar se veprimet e tjera gjatë gjykimit janë kryer prej saj në përputhje me të drejtat procedurale *(shih paragrafët 35-36 të vendimit)*; (ii) nisur nga natyra dhe objekti i padisë, volumi i konsiderueshëm i legjislacionit dhe ndryshimet e tij, numri i palëve në proces, kërkesat procedurale të paraqitura prej tyre, kalimet procedurale të kryera nga gjykatat përgjatë procesit, thirrjet në gjykim të subjekteve që për shkak trashëgimie ose ndryshimi përgjegjësie kanë ndërhyrë në të drejtat e subjekteve të mëparshme në gjykim, si dhe njoftimet për gjykimin e palëve që kanë hyrë në të drejtat e subjekteve që kanë ndërruar jetë, çështja paraqitet komplekse në këndvështrimin kushtetues, në atë masë që e bën faktor përcaktues të kohëzgjatjes tërësore të gjykimit të çështjes së kërkueses, si dhe të tejzgjatjes së gjykimit aktual në gjykatën e apelit *(shih paragrafët 38-43 të vendimit);* (iii) sjellja e autoriteteve nuk është bërë shkak për kalimin e afatit të parashikuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja "a", i KPC-së *(shih paragrafin 47 të*

vendimit); (iv) në këndvështrim të qëndrimit të Gjykatës së Lartë, që ka përcaktuar se në gjykimin administrativ kërkimi lidhet me të drejtën substanciale të pronës, interesi i kërkueses për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm është i rëndësishëm *(shih paragrafin 50 të vendimit)*.

8. Ndërsa bashkohem me shumicën për sa i përket kalimit të afatit të shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, pas kthimit të saj nga Gjykata e Lartë, kritereve kushtetuese mbi të cilat ajo ka vlerësuar pretendimin e kërkueses për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, kompleksitetit të çështjes dhe interesit të kërkueses për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm, ndaj qëndrim pjesërisht të kundërt me të për sa i përket vlerësimit të kriterit të *"sjelljes së kërkueses"*, ndërsa të kundërt për sa i përket vlerësimit të kriterit të *"sjelljes së autoriteteve"*.

9. Kështu, në lidhje me kriterin e *"sjelljes së kërkueses"*, ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për sa i përket faktit se gjatë gjykimit kërkuesja ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, por nuk bie dakord me të për sa i përket qëndrimit se ajo është bërë pjesërisht shkak për tejzgjatjen e gjykimit si rrjedhojë e paraqitjes së kërkesëpadisë në gjykatën jokompetente dhe rekursimit të vendimit të gjykatës për dërgimin e çështjes gjykatës kompetente. Në kundërshtim nga sa shumica arsyeton, përdorimi i mjeteve juridike në dispozicion përmes paraqitjes së kërkesëpadisë nga kërkuesja, ndonëse jo në gjykatën kompetente, ka pasur si qëllim zgjidhjen e çështjes për të cilën ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor dhe nuk ka synuar abuzimin me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për qëllime të zgjatjes në kohë të këtij procesi.

10. Për sa i përket kriterit të *"sjelljes së autoriteteve"*, shumica ka marrë në analizë informacionin e dërguar nga Gjykata Administrative e Apelit në lidhje me çështjet për shqyrtim përpara saj në raport me numrin e gjyqtarëve, çështjet për shqyrtim nga gjyqtarja relatore dhe numrin e seancave të zhvilluara prej saj për çështjen e kërkueses. Në përfundim, shumica ka vlerësuar se sjellja e autoriteteve nuk është bërë shkak për kalimin e afatit të parashikuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja "a", i KPC-së, ndërkohë që është ndalur në vlerësimin e kohëzgjatjes së gjykimit të çështjes në secilën gjykatë të juridiksionit të zakonshëm, pa marrë në analizë vendimin e gjyqtarit të vetëm të Gjykatës së Lartë për kthimin kërkueses të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit dhe përshpejtimin e procedurave nga Gjykata Administrative e Apelit. Në ndryshim nga shumica, çmoj se në rastin e kërkueses qasja tejet formaliste dhe në kundërshtim me jurisprudencën kushtetuese *(shih vendimet nr. 58, datë 17.9.2024; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)* që ky gjyqtar ka mbajtur përmes vendimit të datës 26.2.2024, ka ndikuar në tejzgjatjen e gjykimit të çështjes nga gjykata e apelit, duke bërë që mjeti juridik i konsideruar efektiv nga ligjvënësi të ndikojë në tejzgjatjen e procesit gjyqësor, duke çuar edhe në vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues për zgjidhjen e çështjes.

11. Në këndvështrim të sa më sipër, në ndryshim nga shumica, vlerësoj se sjellja e autoriteteve nuk ka qenë në nivelin e duhur për sa i përket eficiencës së gjykimit. Kjo për shkak se, në zbatim të dispozitave të KPC-së që rregullojnë paraqitjen e kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit, ishte detyrë e Gjykatës së Lartë t'i garantonte kërkueses mjetet juridike efektive të përcaktuara në nenet 399/1 e vijues të KPC-së, duke marrë në shqyrtim, analizuar, vlerësuar dhe arsyetuar në lidhje me pretendimet e ngritura prej saj në kërkesën drejtuar kësaj gjykate në datën 9.1.2024.

12. Po kështu, ashtu, si shumica ka pranuar, nisur nga natyra e kërkimeve të kërkueses në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, të cilat kanë të bëjnë me të drejtën subjektive të pronës, interesi i kërkueses në çështje është i lartë. Megjithatë, krahas këtij fakti, një faktor tjetër që Gjykata duhej të kishte marrë në konsideratë në rastin konkret, ashtu siç ajo ka vlerësuar edhe në raste të mëparshme *(shih vendimin nr. 25, datë 11.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese),* është edhe mosha e kërkueses, e cila rezulton të jetë 77 vjeçe, ndaj edhe në këtë aspekt, tejzgjatja e procedurave gjyqësore paraqet rrezik për realizimin në kohë prej saj të së drejtës së pronës.

13. Në përfundim, bazuar në argumentet e mësipërme, duke pasur parasysh sjelljen e kërkueses dhe moshën e saj, si dhe sjelljen e autoriteteve, vlerësoj se krahas shfuqizimit të vendimit të Gjykatës së Lartë për shkak të cenimit të së drejtës së kërkueses për akses në atë gjykatë dhe për

mjete juridike efektive, Gjykata duhej të kishte vendosur pranimin edhe të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit.

Anëtare: Sonila Bejtja